



*Në bazë të nenit 69, 70 dhe 71 të Statutit të Fakultetit të Shkencave Islame – Shkup, Dekani i Fakultetit, lëshon këtë:*

## **NJOFTIM**

Ligjëratat në semestrin dimëror të vitit Akademik 2021 - 2022 do të përfundojnë më 13 janar 2022 (e ejnte).

Studentët obligohen që të marrin nënshkrimet për lëndët e dëgjuaara gjatë semestrit dimëror të vitit Akademik 2021-2022, prej 06 – 20 janar 2022.

Verifikimi i Semestrit dimëror të vitit Akademik 2021-2022 do të bëhet prej 13 – 28 janar 2022. Studentët gjatë verifikimit të semestrit obligohen që të kenë të marra të gjitha nënshkrimet nga ligjëruesit (*lejohet me minus dy nënshkrime*) dhe të kenë dëshmi për pagesë në vlerë prej 300 denarësh.

Dorëzimi i punimeve individuale dhe seminarike do të bëhet prej datës prej 21 - 03 shkurt 2022.

Paraqitja e provimeve për semestrin veror për afatin e III-të, të shkurtit do të filloj prej datës 14 – 20 janar 2022.

Afati i provimeve për semestrin veror 2020-2021 do të filloj prej 21 janar – 03 shkurt 2022.

Paraqitja e provimeve për semestrin dimëror 2021-2022 për afatin e I-rë, të shkurtit do të filloj prej datës 28 – 03 shkurt 2022.

Afati i provimeve për semestrin dimëror 2021-2022 do të filloj prej 04 - 14 shkurt 2022.

Paraqitja e provimeve me *komision* për semestrin veror - afati i IV-të, do të filloj prej 28 – 03 shkurt 2022.

Afati i katërt me *komision* i provimeve për semestrin veror 2020-2021 do të filloj prej 04 - 14 shkurt 2022.

Regjistrimi i semestrit veror për vitin Akademik 2021-2022 do të realizohet në periudhën kohore prej 07 - 14 shkurt 2022.

Ligjëratat për semestrin veror të vitit Akademik 2021-2022 do të fillojnë më 15 shkurt 2022 (e martë).

### **VËREJTJE:**

*Për terminët e provimeve studentët do të jenë të informuar me kohë me njoftim të veçantë. Studentët paraqitjen e provimit obligohen ta bëjnë me indeks.*

***Assoc. Prof. Dr.sc Shaban Sulejmani, Dekan***